
LIGJ

Nr.9876, datë 14.2.2008

PËR PRODHIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E
BIOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË
RINOVUESHME, PËR TRANSPORT

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj synon promovimin e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për zëvendësimin e nënprodukteve të naftës për sektorin e transportit, për të kontribuar në përmbushjen e angazhimeve të ndërmarra, në kuadër të Protokollit të Kiotos për ndryshimet klimatike, si dhe për të siguruar furnizimin e promovimin me burime energjetike të rinovueshme, nëpërmjet nxitjes e kultivimit të bimëve energjetike, për të mbrojtur mjedisin.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet në veprimtaritë e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, të cilat, në formë të pastër ose të përzier, në përqindje të caktuar me nënprodukte të tjera të rafinimit të naftës bruto, përdoren në sektorin e transportit për motorë me djegie të brendshme.
2. Prodhimi dhe përdorimi i biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera

djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose si përzierje, në sektorin e transportit, bëhen kur ato janë në përputhje me standardet evropiane, të përshtatura si standarde kombëtare nga organi kombëtar i standardizimit, ose me standardet e tjera të barasvlershme me to.

Neni 3

Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Biomasa" është fraksionimi i produkteve, mbetjeve dhe mbeturinave të shpërbëshme organike, që përfitohen nga veprimtaria bujqësore, ku përfshihen lëndët bimore dhe shtazore, ato pyjore dhe lëndë të ngjashme industriale, si dhe fraksionimi i mbeturinave të shpërbëshme organike industriale, i mbeturinave të shpërbëshme organike rurale dhe urbane.
- b) "Biokarburante" janë lëndë djegëse, në trajtë të lëngët ose të gaztë, për transport, të cilat prodhohen nga biomasa dhe veçanërisht:
 - i) "Biodiezel (diezel me prejardhje organike)" është metil-esteri yndyror dhe etil-esteri i acideve yndyrore metilike, që prodhohen nga vajra bimore (biomasa) ose shtazore dhe nga dhjamëra të cilësisë së diezelit, si nënprodukt i rafinimit të naftës bruto, për t'u përdorur si biokarburant.
 - ii) "Bioetanol" është etanoli, që prodhohet nga biomasa ose nga fraksionimi i mbeturinave të shpërbëshme organike, me cilësinë e benzinës, si nënprodukt i rafinimit të naftës bruto, për t'u përdorur si biokarburant.
 - iii) "Biogaz" është lëndë djegëse e gaztë, që prodhohet nga biomasa ose fraksionimi i mbeturinave organike, industriale dhe urbane, të shpërbëshme, të cilat mund të pastrohen dhe të përmirësohen, në cilësinë e gazit natyror, për t'u përdorur si biokarburant ose gaz druri.
 - iv) "Biometanol" është metanoli, që prodhohet nga biomasa, për t'u përdorur si biokarburant.
 - v) "Biodimetileter" është dimetileteri, që prodhohet nga biomasa, për t'u përdorur si biokarburant.
 - vi) "Bio-ETBE" është Etil-Tercio-Butil-Eter, që prodhohet nga bioetanol, për t'u përdorur si biokarburant. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-ETBE-it, që përllogaritet si biokarburant, është 47 për qind e totalit të tij.
 - vii) "Bio-MTBE" është Metil-Tercio-Butil-Eter, që prodhohet nga biometanoli, për t'u përdorur si biokarburant. Përqindja, sipas vëllimit të Bio-MTBE-it, që përllogaritet si biokarburant, është 36 për qind e totalit të tij.
 - viii) "Biokarburant sintetik" janë hidrokarburet sintetike ose përzierja (mishela) e hidrokarbureve sintetike, që prodhohen nga biomasa.

- ix) "Biohidrogjen" është hidrogjeni, që prodhohet nga biomasa dhe/ose nga fraksionimi i shpërbërjes së mbeturinave organike, industriale dhe urbane, për t'u përdorur si biokarburant.
- x) "Vajra bimore të pastra" janë vajrat që prodhohen nga bimë vajore energjetike, me shtypje, shtrydhje ose metoda të tjera, në gjendje natyrore ose të përmirësuara, por të pandryshuara kimikisht, kur përshtaten me tipin e motorit ose të pajisjes së përdorur dhe me kërkesat përkatëse të emetimeve të ndotjeve të gazit, sipas legjislacionit në fuqi.
- c) "Lëndë të tjera djegëse të rinovueshme" janë lëndët djegëse të rinovueshme, përveç biokarburanteve, që kanë prejardhje nga burime jofosile të energjisë së rinovueshme, të cilat përdoren për qëllime transporti, sikurse janë energjia e biomasës, e gazit të landfillit, e gazit të impianteve të trajtimit të ujërave urbane dhe të biogazit.
- ç) "Prodhimi i biokarburanteve" është përpunimi i lëndëve të para të përshtatshme në impiante të posaçme, për prodhimin e vetë biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.
- d) "Njësi të prodhimit të biokarburanteve" janë personat juridikë, të cilët zotërojnë impiante për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.
- dh) "Impiante për prodhimin e biokarburanteve" janë impiantet e posaçme, ku realizohet prodhimi i biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përfshirë edhe mjediset e nevojshme të magazinimit dhe të shpërndarjes (lëvrimit).
- e) "Kultivim energjetik" është prodhimi, importimi ose tregtimi i atyre bimëve, për prodhimin e produkteve, që vlerësohen lëndë djegëse, me bazë organike ose lëndë të para për prodhimin e këtyre lëndëve djegëse.
- ë) "Përmbajtja energjetike" është fuqia minimale kalorifike (termogjene) e një lënde djegëse.
2. Biokarburantet e lëngshme ose të gazta dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, të cilat, kur përdoren të pastra ose si përzierje (mishelë) me produkte të tjera të rafinimit të naftës bruto, i zëvendësojnë këto produkte të naftës, quhen, gjithashtu, nënprodukte të naftës, në kuptim të dispozitave të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, duke iu referuar kategorive respektive të nënprodukteve të naftës që ato zëvendësojnë, sipas grupit të përcaktuar në këtë ligj për këto kategori.

Neni 4

Objektivat

Gjatë ushtrimit të veprimtarive të prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, synohen:

- a) nxitja e prodhimit dhe e përdorimit të biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në sektorin e transportit, nëpërmjet vendosjes së objektivave tregues kombëtarë, të shprehur në përqindje, për praninë në treg të këtyre produkteve;
- b) garantimi i efektshmërisë optimale të punës së motorit, duke respektuar normat e cilësisë dhe ato teknike në prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme;
- c) kontributi në mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik;
- ç) zhvillimi i qëndrueshëm i sektorëve të bujqësisë dhe të pyjeve;
- d) ulja e sasisë së emetimeve të dëmshme, të çliruara në ajër nga veprimtaritë në sektorin e transportit.

KREU II

ORGANIZIMI I VEPRIMTARIVE TË PRODHIMIT DHE TË TREGTIMIT TË BOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË RINOVUESHME

Neni 5

Njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, organizohen si person juridik, të krijuara në formën e shoqërive anonime, sipas legjislacionit në fuqi, që ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.
2. Ndërtimi dhe funksionimi i impianteve të prodhimit të biokarburanteve ose i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, bëhen pasi njësitë që i zotërojnë ato të jenë pajisur, sipas dispozitave të këtij ligji, me "leje prodhimi".
Shfrytëzimi i impiantit të prodhimit të biokarburanteve fillon pas certifikimit të dhënë nga Inspektorati Qendror Teknik, që vëren se janë plotësuar kushtet teknike, të cilat duhet të respektohen gjatë të gjithë afatit të përcaktuar në "lejen e prodhimit".
3. Njësitë për prodhimin e biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, kanë të drejtë t'i shesin vetë produktet e tyre, në vend ose jashtë tij. Shitja në vend e biokarburanteve ose e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, nga këto njësi, bëhet vetëm në rafineritë e

naftës ose në shoqëritë e tregtimit me shumicë, të pajisura me lejet përkatëse nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet.

4. Njësitë për prodhimin e biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përgjigjen për markën e prodhimit dhe cilësinë e produkteve që prodhojnë.

5. Këto njësi kanë të drejtë të themelojnë apo të marrin pjesë në shoqëritë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë ose me pakicë të prodhimeve të tyre.

6. Njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, janë të detyruara të paraqesin në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet të dhëna për programin e zhvillimit, si dhe të dhëna periodike për realizimin e veprimtarisë së tyre.

Lloji i të dhënave, forma dhe afatet e dërgimit të tyre nga njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, përcaktohen nga kjo ministri.

Ministria përgjigjet për përpunimin dhe botimin e këtyre të dhënave, sipas formës, afateve dhe mënyrës së botimit të përcaktuar.

Neni 6

Përgatitja për tregtim e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, mund të disponohen dhe të tregtohen në formë të pastër ose si përzierje me produktet e përpunimit të naftës bruto, vetëm kur përmbushin standardet teknike, që përcaktohen në legjislacionin shqiptar në fuqi.

2. Ruajtja, magazinimi, transportimi dhe përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, duhet të realizohen në depozita ose impiante magazinimi dhe transportimi të përshtatshme për këto lloj produktesh, të cilat plotësojnë kushtet dhe parametrat teknikë dhe të si gurisë, të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

3. Përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto realizohet vetëm në instalimet e posaçme dhe në përgjegjësinë e personave të pajisur me "leje koncesioni", për rafineritë e naftës bruto, ose "leje tregtimi", për shoqëritë e tregtimit me shumicë të nënprodukteve të naftës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

4. Rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë të nënprodukteve të naftës, të cilat tregtojnë edhe biokarburante dhe lëndë të tjera djegëse, të rinovueshme, duhet të disponojnë instalime për

depozitim e tyre dhe për realizimin e përzierjes së biokarburanteve me nënprodukte të rafinimit të naftës bruto. Këto rafineri e shoqëri përgjigjen për funksionimin e këtyre instalimeve, në përputhje me normat teknike, të miratuara nga ministria dhe me masat e mbrojtjes nga zjarri (MNZ).

5. Instalimet, ku realizohet përzierja e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me produktet respektive konvencionale të distilimit të naftës bruto, duhet të jenë të licencuara si magazina doganore, publike ose private, në zbatim të kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Organizimi i tregut të biokarburanteve dhe i lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Veprimtaritë e importimit, të eksportimit dhe të tregtimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose në formë përzierje me nënprodukte të rafinimit të naftës bruto, realizohen nga njësitë e prodhimit të biokarburanteve ose të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, nga rafineritë e përpunimit të naftës bruto, të pajisura me "leje koncesioni" dhe nga shoqëritë e pajisura me "leje tregtimi" për tregtimin me shumicë të nënprodukteve të naftës. Shoqëritë e tregtimit me pakicë të nënprodukteve të naftës, të pajisura me "autorizim", sipas dispozitave ligjore në fuqi, kanë të drejtë të shesin me pakicë biokarburante në formë të pastër ose në formë të përzier me nënprodukte të rafinimit të naftës bruto, duke zbatuar dispozitat e këtij ligji.

2. Në dokumentacionin përkatës doganor dhe administrativ shoqërues të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në formë të pastër ose të përzier me nënprodukte të rafinimit të naftës bruto, duhet të përcaktohet në mënyrë të detyrueshme përqindja e biokarburantit ose e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që përziehet me nënproduktin respektiv të rafinimit të naftës bruto.

3. Zotëruesit e "lejes së tregtimit" për tregtimin me shumicë dhe të "autorizimit" për tregtimin me pakicë të nënprodukteve të naftës, të cilët tregtojnë edhe biokarburante, janë të detyruar që në instalimet e tregtimit ose në pikat e shitjes së tyre të afishojnë, në mënyrë të dukshme dhe të qartë, një shënim të posaçëm për:

- a) biokarburantet ose lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme;
- b) biodiezelin e përzier me diezel, për lëvizje automjetesh, në përqindje, minimalisht, 5 për qind për vëllim;
- c) bioetanolin e përzier me benzinë, në përqindje, minimalisht, 5 për qind

për vëllim.

Karakteristikat e shënimit të posaçëm përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet, i cili botohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 8

Objektivat për përcaktimin e sasisë vjetore minimale në treg të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme

1. Në objektivat tregues kombëtarë vjetorë, të shprehur në përqindje, për nxitjen e përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në sektorin e transportit, duhet të përcaktohet përqindja minimale në treg e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, në raport me sasinë vjetore të benzinës dhe diezelit të përdorur në sektorin e transportit.

Përlllogaritja e përqindjes, për periudhën e plotë vjetore, bëhet në bazë të përmbajtjes energjetike të totalit të lëndëve djegëse (diezelit dhe benzinës) që tregtohen për transport.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë udhëzimin për mënyrën e përcaktimit të sasisë vjetore minimale në treg të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për sektorin e transportit dhe të ministrit përgjegjës për sektorin e hidrokarbureve, përcakton sasinë minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që do të përdoren gjatë vitit pasardhës në sektorin e transportit, propozim, i cili, në çdo rast, paraqitet deri më 30 prill të vitit në vazhdim nga ministri përgjegjës për sektorin e hidrokarbureve.

Në rastin kur të dy ministrat nuk veprojnë bashkërisht deri në këtë afat, nisma për propozim i mbetet ministrit përgjegjës për hidrokarburet.

3. Të dhënat për sasinë minimale të biokarburanteve, që do të përdoren në sektorin e transportit gjatë vitit pasardhës, botohen në media dhe në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet dhe të ministrisë përgjegjëse për transportin.

4. Përcaktimi i sasisë minimale vjetore në treg të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, e cila nuk mund të jetë më e vogël se 3 për qind, do të fillojë nga viti 2010, ndërsa nga viti 2015 e në vazhdim kjo sasi nuk mund të jetë më e vogël se 10 për qind.

5. Në rastet kur sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që ofrohet në treg nga prodhuesit vendas, është më e madhe se sasia minimale vjetore, e përcaktuar nga

Këshilli i Ministrave, çdo njësi prodhimi të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, i garantohet të hedhë në treg një sasi minimale vjetore të këtyre produkteve, në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 1 të këtij neni, e cila nuk kufizon të drejtën e tyre për të tregtuar sasi edhe më të mëdha, në përputhje me kërkesën e tregut.

6. Kur nga programet vjetore të zhvillimit, njësitë për prodhimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, parashikojnë se prodhimi vjetor vendas i këtyre produkteve nuk mbulon të gjithë sasinë minimale vjetore, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për t'u hedhur në treg, shoqëritë e tregtimit me shumicë, të pajisura me "leje tregtimi" për nënproduktet e naftës, detyrohen të garantojnë furnizimin e tregut me këtë sasi minimale vjetore.

Procedurat për përcaktimin e sasive minimale vjetore të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që duhet të garantojë secila shoqëri në treg, jepen në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 1 të këtij neni.

Sasia minimale vjetore e biokarburanteve dhe e lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që detyrohet të garantojë çdo shoqëri e tregtimit me shumicë për ta hedhur në treg, për përmbushjen e objektivit për sasinë minimale vjetore, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për këto produkte, nuk kufizon të drejtën e tyre për të tregtuar sasi edhe më të mëdha, në përputhje me kërkesën e tregut për konsumin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

Neni 9

Leja e prodhimit

1. Personat juridikë të organizuar (krijuar) si njësi për prodhimin e biokarburanteve, në përputhje me përcaktimin e pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, pajisen me "leje prodhimi" për të ushtruar veprimtarinë e prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, kur plotësojnë kushtet e procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Leja e prodhimit jepet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet përpara fillimit të punimeve për ndërtimin e implantit të prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Leja e prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, jepet për një afat 30 vjet, me të drejtë ripërsëritjeje.

4. Shoqëritë e pajisura me "leje prodhimi" mund të kryejnë edhe

veprimtarinë e tregtimit (importimit dhe/ose eksportimit) të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji, si dhe t'i mbajnë ato brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të kontratave me njësitë e prodhimit të biokarburanteve, me zotëruesit e lejes së koncesionit për rafineritë e naftës, të lejes së tregtimit të llojit "A", për tregtimin e nënprodukteve respektive të rafinimit të naftës, si dhe me konsumatorët e mëdhenj fundorë.

5. Për një konkurrencë transparente, zotëruesit e "lejes së prodhimit" për impiantet e prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, detyrohen të raportojnë pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet analizën e çmimit të prodhimit në fabrikë (ex factory) të këtyre produkteve.

Neni 10

Regjimi tatimor

1. Biokarburantet dhe lëndët e tjera djegëse, të rinovueshme, që përdoren në sektorin e transportit, si dhe lëndët e para, që përdoren për prodhimin e tyre u nënshtrohen një trajtimi të veçantë tatimor, që i bën ato të konkurrueshme në treg.

Në periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në vitin 2018, niveli i akcizës për këto produkte do të jetë zero.

2. Janë subjekt i një regjimi të veçantë doganor dhe taksash të gjitha makineritë, materialet dhe pajisjet, që shërbejnë dhe janë pjesë e objekteve të prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, me të cilat, por pa u kufizuar vetëm në to, nënkuptohen:

a) pajisjet dhe makineritë, që shndërrojnë plehun organik në përmirësues organik të tokës, që përdoret për kultivimin energjetik;

b) pajisjet, materialet dhe makineritë bujqësore, që do të përdoren nga fermerët vendorë për kultivimin energjetik;

c) pajisjet dhe makineritë teknologjike, kryesore dhe ndihmëse, të impianteve të prodhimit të biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme.

Për periudhën e parë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në vitin 2012, këto pajisje, materialet dhe makineri përjashtohen nga taksa doganore dhe TVSH-ja, që do të thotë se niveli i të cilave do të jetë zero.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të domosdoshëm, që duhet të plotësojnë subjektet, për të përfituar këto lehtësi, sikurse

përcaktohet në pikat 1 e 2 të këtij neni.

Neni 11

Sanksionet

1. Kryerja e veprimtarisë së njësive të prodhimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, si më poshtë:

a) shkeljet e pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji, me 800 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

b) shkeljet e pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;

c) shkeljet e pikës 6 të nenit 5 të këtij ligji, me 30 000 lekë deri në 50 000 lekë;

ç) shkeljet e pikës 2 të nenit 6 të këtij ligji, me 1 000 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;

d) shkeljet e pikave 2 e 3 të nenit 7 të këtij ligji, me 300 000 lekë deri në 500 000 lekë.

2. Kur veprimtaria ushtrohet pa lejet përkatëse, sipas dispozitave të këtij ligji, subjekti gjobitet me 4 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda tri muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet përkatëse nënligjore në zbatim të neneve 8, 9 e 10 të këtij ligji.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5636, datë 25.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi